



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 7 korrik 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: ministri i Ministrisë së Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar; drejtori i Doganave, z. Lulzim Rafuna; ud. drejtori i ATK-së, z. Nahit Sharku; Florina Merovci – ZPRK; Fitim Sadiku dhe Ergin Kala – MAP; Granit Fetahu – PK; Valdete Krasniqi dhe Enver Durmishi – DK; Hamit Mulaj – ATK; Artan Venhari, Qëndresa Mulaj, Vlora Mehmeti, Fatlinda Ramosaj, Valbon Bytyçi dhe Arben Selimi – ZAP; Sanije Berisha – OSBE; Kaltrina Ahmeti – GLPS; Bleta Gashi - Rrokum TV; Etleva Skoja- “Kosova Sot”; Tringa Bytyçi – GLPS.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi, Saranda Kaçiu, praktikante, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zëvendëskryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 17.6.2015;

3. Shqyrtimi i Rekomandimeve nga Raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i Vendimit, me propozim të znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, për kandidatin për kryesues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Integriteteve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;
6. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve zyrtare;
7. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.6.2015

Zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 17.6.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Rekomandimeve nga Raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014

Zëvendëskryetari - Raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014, është shqyrtuar në mbledhjen e fundit të Komisionit. Prandaj, bazuar në përfundimet, administrata e KMFP-së ka përgatitur rekomandimet të cilat i keni marrë dhe i keni shqyrtuar. Edhe unë e vlerësojë që këto rekomandime t'i shkojnë drejtpërdrejt Ministrisë së Financave, përkatësisht Njësisë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm. A ka dikush diçka për të plotësuar ose propozuar në lidhje me këtë pikë?

Meqenëse nuk pati të interesuar për të diskutuar, kjo pikë e rendit të ditës u hodh në votim. Komisioni, unanimisht, votoi Rekomandimet për Ministrinë e Financave, përkatësisht NJQHAB-në.

Përfundim

Rekomandimet e Komisionit, të dala nga raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014, nuk do të adresohen për seancë plenare, por do të adresohen nga KMFP për MF përkatësisht NJQHAB.

4. Shqyrtimi i Vendimit me propozim të znj. Atifete Jahjaga, Presidente e

Republikës së Kosovës, për kandidatin për kryesues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Zëvendëskryetari njoftoi deputetët dhe të pranishmit se Presidentja e Republikës së Kosovës ka përgatitur vendimin me propozim për auditorin e përgjithshëm, të njëjtin e ka dërguar në Kuvend për shqyrtim. Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar KMFP-në që ta shqyrtojë propozimin e Presidentes dhe Kuvendit t'i paraqesë raport me rekomandime. Andaj, unë e mendoj se kjo çështje duhet të diskutohet në seancë plenare. Nëse ju pajtoheni, që ne si Komision të rekomandojmë që të procedohet për diskutim në seancë. A keni diçka për të shtuar?

Anëtarët e Komisionit, unanimisht, ishin të mendimit që kjo çështje të procedohet për shqyrtim në seancë.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të nxjerrë një rekomandim që, Vendimi me propozimin e znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, për kryesues të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të adresohet në seancë plenare për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Zëvendëskryetari njoftoi deputetët dhe të pranishmit se Ministri i Integrimeve Evropiane nuk do të marrë pjesë në këtë takim për shkak se këto dy javë pret një delegacion të Bashkimit Evropian për Liberalizim të Vizave, mirëpo unë propozoj se raporti për Integrime Evropiane të diskutohet në takimin e radhës së KMFP, edhe pse është hera e dytë që komisioni e ka në rend ditë këtë raport por në mungesë të Ministrit nuk po arrin ta shqyrtojë.

Përfundim

Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, të renditet për shqyrtim në mbledhjen e radhës së KMFP.

6. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve zyrtare

Zëvendëskryetari – Tani e ftojme ministrin e Administratës Publike, z.Mahir Yagcilar, për të diskutuar për Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Administratës Publike për vitin 2014 dhe Raportin e performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve zyrtare. Para se t'ia japim fjalën Ministrit, e ftoj ta paraqesë në përmbledhje auditoren që e ka kryer këtë auditim.

Vlora Mehmeti - Opinioni i auditimit për pasqyrat vjetore financiare për MAP-në për vitin 2014, është se ato prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Të gjeturat në këtë raport kanë të bëjnë me: planifikimin dhe realizimin e buxhetit, shpenzimet përmes prokurimit, menaxhimit e pagave dhe mëditjeve, subvencionet dhe transferimet, menaxhimit e pasurisë dhe të gjeturat në lidhje me auditimin e brendshëm.

Zëvendëskryetari – Tani vazhdojmë me të gjeturat e Raportit të performancës në Ministrinë e Administratës Publike.

Fatlinda Ramosaj – Të gjeturat në këtë raport janë: ministria nuk mban një regjistër për pjesët e ndërruara, i mban vetëm si shpenzime totale, e jo për sasi. Ministria e Administratës Publike nuk ka bërë as hulumtim të tregut, as krahasimin e çmimeve. Një dobësi tjetër është blerja e automjetit me garanci, kurse ministria ka dhënë edhe një shumë prej 3000 euro shtesë për riparim, për një pjesë që ishte e përfshirë në garanci.

Synavere Rysha – Pse Ministria e Administratës Publike e ka bërë shpenzimin e buxhetit vetëm në tremujorin e fundit, cilat kanë qenë arsyet? Gjithashtu, cila ka qenë arsyeja për mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre, në mënyrë të jashtëligjshme?. Pse nuk është bërë menaxhimi i duhur për përdorimin e automjeteve zyrtare?

Sa i përket raportit të performancës, pse nuk keni bërë një hulumtim të tregut për të arritur të çmimi më i arsyeshëm dhe çmimi më i mirë?

Naim Fetahu – Në bazë të raportit, kam vërejtur se në vitin 2014, kemi një progres në kuptim të implementimit të rekomandimeve që janë dhënë. Te raporti i performancës, u cek që nuk e keni një regjistër të saktë të ndërrimit të pjesëve të automjeteve. Cila është arsyeja? Gjithashtu, çmimet për këto pjesë janë dyfish më të mëdha se ato të tregut. A keni bërë hulumtim të tregut apo keni qenë të detyruar? Sepse, në disa raste, nëse automjetet janë të një kompanie të caktuar, atëherë edhe mirëmbajtja duhet të bëhet prej tyre. Më tutje, pse nuk është zbatuar rregullorja për ndarjen e subvencioneve, cilat kanë qenë arsyet?

Zëvendëskryetari – Raporti i performancës në lëmin e servisimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, nxjerr në sipërfaqe disa mangësi, të cilat kërkojnë një adresim konkret. E para, nuk kanë një planifikim të nevojave dhe në shumicën e rasteve kanë shkuar me kuotë të çmimeve. Këtu nuk përjashtoheni as ju, si ministri. Gjithashtu, një çështje që e kemi diskutuar shumë herë, është montimi i GPS-ve për përdorimin e automjeteve. Pse nuk shfrytëzohet GPS-i dhe cilat janë planet e juaja si ministri rreth kësaj çështjeje?

Mahir Yagcilar – Sa i përket raportit të performancës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve zyrtare të Ministrisë së Administratës Publike për vitin 2014, në përgjithësi, raporti përmban të dhëna të sakta për përdorimin e automjeteve për vitin 2014, por nuk janë marrë parasysh rreziqet në raste të caktuara. Është e vërtetë se nuk ka pasur një analizë të mirëfilltë të mirëmbajtjes dhe riparimeve të automjeteve zyrtare, edhe përkundër faktit që nuk ka pasur një analizë të shkruar dhe rekomandime konkrete të dala nga kjo analizë. Ne, si Ministri e Administratës Publike, i kemi zvogëluar kostot e shpenzimeve në lidhje me mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve. Pra, nëse iu referohemi tabelave të shpenzimeve, konstatojmë se Ministria e Administratës Publike për vitin 2011, ka shpenzuar 45.720 euro, për vitin 2012 ka

shpenzuar 39.020 euro, për vitin 2013 ka shpenzuar 31.757 euro. Ndërsa, sa i përket çështjes se a mbahet evidencë për pjesët e riparuar apo të ndërruara, Ministria e Administratës Publike mban evidencë dhe posedon të dhëna mbi pjesët e riparuar apo të ndërruara. Sa i përket tenderimit, unë jam i mendimit që çdo institucion nuk duhet ta bëjë tenderimin për automjete, së paku duhet të bëjnë tenderime për të njëjtin lloj të automjeteve, sepse shumica e serviseve nuk kanë mundësi të përmbajnë të gjitha automjetet. Sa i përket çmimit të tregut, të gjitha çmimet e tregut varen edhe prej raporteve ndërmjet valutave të ndryshme. Ne pranojmë se do të veprojmë sipas rekomandimeve të AP, që në të ardhmen angazhimi i automjeteve mund të bëhet edhe përmes lizingut. Gjithashtu, më duhet të theksoj se me vjetërsimin e automjeteve, rriten shpenzimet në automjete. Një çështje që duhet të theksoj, është se ndoshta në të ardhmen do të ishte mirë të bëhet planifikimi i buxhetit edhe sipas analizave.

Zëvendëskryetari – Auditori e ngriti çështjen se pjesët e ndërruara nuk kanë evidencë, mungon një planifikim i nevojave, pastaj në të shumtën e rasteve, është shkuar në kuotë të çmimeve. Gjithashtu te përdorimi i GPS – ve, nuk morëm përgjigje. Është mirë që edhe aty të referoheni.

Mahir Yagcilar – Po, mendoj që në të ardhmen, por vetëm MAP-ja nuk mundet, sepse duhet të ketë një bashkëpunim ndërmjet institucioneve, që servisimi të bëhet sipas llojeve, atëherë do të krijohen mundësitë për kursime. Sa i përket GPS-ve, ka qenë një projekt i cili ka filluar dhe një kohë është zbatuar dhe ende është duke u zbatuar. Në këtë moment është në përdorim, sepse e ka edhe atë periudhën e rimbursimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose në Policinë e Kosovës, ndërsa në institucionet tjera, ka kaluar periudha e rimbursimit.

Zëvendëskryetari – Zoti ministër, ju jeni pjesë e Qeverisë, cilët janë hapat e MAP-së për tejkalimin e këtyre? Po flisni për GPS-në, si një projekt i dështuar. Kush e hartoi atë dhe kush e mban përgjegjësinë? Tani po ngritni koston e tij, a ka kosto apo interes që të ketë GPS apo të mos ketë fare?

Fitim Sadiku – Projekti është funksional, mirëpo sikurse që mbushja për telefonin që duhet të rimbushet, që ta përdorim telefonin për thirrje, po ashtu dhe GPS-i duhet mbushur. Është bërë kostoja për vitin e kaluar, ka ndodhur që Agjencia për Shoqëri të Informacionit, të gjitha mjetet që i ka pasur në fushën e TI-së janë reduktuar. Për mallra dhe shërbime kapitale agjencia nuk e ka asnjë mjet për këtë vit, sikur të kishte mjete të planifikuara për këtë destinim, normal që edhe GPS-të do të kishin funksionuar dhe sot do të kishim një menaxhim më të mirë të automjeteve. Sa i përket procedurave, u përmend që shumica kanë qenë kuotime. Po përmendi që prej nëntë procedurave, vetëm dy kanë qenë kuotime të çmimeve, tri kanë qenë procedura të hapura, një ka qenë e negociuar dhe tri procedura me çmim minimal. Sa i përket listës së mjeteve të ndërruara, ne e kemi historikun e secilit automjet. Nuk kemi një listë të vetme, mirëpo kemi dosje të veçantë për secilin automjet dhe është historiku ku përmban të dhënat e të gjitha pjesëve të ndërruara të automjeteve, që nga momenti kur është blerë automjeti. Duhet të kemi parasysh edhe faktin se kemi automjete që nga viti 2002, që në vendet e tjera kur ai i kalon shtatë vjet, amortizohet dhe nuk është i sigurt për vozitje. Ne nuk kemi garanci që nëpunësit tanë janë të sigurt të dalin në terren me këto vetura, të cilat i kanë 12-13 vite. Ne kemi 30-40 objekte jashtë Prishtinës që i menaxhojmë. I kemi diku 70-80 antena, secila antenë e ka një gjenerator.

Ai gjenerator mund të prishet në çdo moment dhe ne duhet të shkojmë t'i servisojmë ata gjeneratorë, duhet të përkujdesemi për derivatet e atyre gjeneratorëve dhe normalisht që na duhen shumë punë në terren dhe çdo vit kemi arritur që ta ulim koston. Duhet të ndodhë e

kundërta, për shkak se vetura shkon duke u dëmtuar çdoherë dhe kostoja për servisim shkon duke u rritur. Kështu që, ne kemi arritur për çdo vit të ulim koston për 6000-7000 euro, që mendoj se është një sukses.

Adem Grabovci – Pse bëhet shpenzimi i buxhetit në fund të vitit, cilat janë arsyet? Ju keni arritur që të hulumtoni të gjeni formën më të mirë sesi të kurseni buxhetin. Është e vërtetë se për një automjet të vjetër, shpenzimet e mirëmbajtjes janë më të mëdha, por ajo që mua po më intereson është se, a keni arritur të bëni një analizë që prej momentit të ndalimit për blerjen e automjeteve të reja, a keni kursyer me këtë vendim? Sepse, nëse ne kemi rritje të shpenzimeve, atëherë ne nuk kemi bërë asgjë. Një tjetër, çështje shumë e rëndësishme është keqpërdorimi i automjeteve zyrtare. Ne po shohim përmes mediave keqpërdorimin e automjeteve zyrtare, që është fyese dhe denigruese për të gjithë ne. Gjithashtu, çështja e GPS-ve ka një rëndësi shumë të madhe. A kemi arritur ne që përmes GPS-ve të kemi kontroll dhe të bëjmë uljen e shpenzimeve, sa ka ndikuar kjo në mënyrë pozitive apo në mënyrë negative? Ne nuk jemi për ta penguar punën e asnjë institucioni lidhur me përdorimin e automjeteve, por ne jemi që t'i reduktojmë shpenzimet lidhur me përdorimin e automjeteve. Forma e lizingut është një formë praktike që e praktikojnë edhe shtetet tjera, pse mos ta kemi edhe ne atë formë.

Synavere Rysha – Ju thatë që rimbushja e GPS -ve po kushton 270 euro në vit. Po duket që nuk i keni bërë projektit një analizë të mirë dhe një test para se të përdoret, i cili po shihet që është një projekt i dështuar. A keni bërë një analizë ku shihet se sa kanë qenë kursimet apo shpenzimet për ata përdorues të GPS –ve, para përdorimit të tyre dhe sa kanë qenë kursimet apo shpenzimet pas përdorimit të GPS –ve? Këtu, ju duhet të bëni një ndarje. Sa i përket mirëmbajtjes, është e vërtetë që një pajisje e vjetër kushton më shtrenjtë për ta mirëmbajtur, por ajo çka po më intereson është se, pse ju për një pajisje që ka kushtuar 12 euro keni shkuar dhe e keni blerë për një çmim shumë të lartë prej 29 euro? Këtu kërkojmë sqarime nga ju. Qëllimi jonë është që ju të kurseni aty ku duhet.

Zëvendëskryetari – Është mirë të sqarohet se në sa ministri është instaluar GPS -i, pastaj sa kohë ka funksionuar ai GPS nëpër këto ministri. Cila është analiza e koston në atë periudhë që ato e kanë përdorur?

Fitim Sadiku – Sa i përket çmimit prej 25 eurosh në muaj për mirëmbajtjen e veturave, nuk është ndonjë shumë e madhe për një veturë që mund të shpenzojë 300-400 litra derivate. Kështu që çdo veturë do të kursejë së paku 100 euro, sepse çdo veturë që e ka GPS –in, do të përdoret ekskluzivisht për qëllime zyrtare.

Adem Grabovci – A keni bërë ju një analizë, pasi që keni bërë vendosjen e GPS -it, sa ka ndikuar ajo në uljen e shpenzimeve? Kjo është shumë e rëndësishme. Për mua është shumë me rëndësi ruajtja e autoritetit të institucionit, sepse ne jemi duke e humbur besimin e qytetarit. A është forma e vetme përdorimi i GPS –it dhe sa është zbatuar ky vendim, që për mendimin tim nuk është zbatuar? Ne po kërkojmë analizë, sepse nuk guxojmë të shkojmë me eksperimente, por ne po kërkojmë rezultate, sa keni kursyer për këto automjete, sepse po shihet që kohëve të fundit është rritur keqpërdorimi i automjeteve zyrtare.

Mahir Yagcilar – Ne do të dërgojmë raportin, sa i përket të dhënave që kemi, por duhet të jemi të vetëdijshëm që ky projekt ka filluar më herët, ndoshta që nga viti 2007, që atëherë ka ndryshuar edhe teknologjia dhe shumë çështje tjera. Për mendimin tim, më nuk ka nevojë, sepse

edhe GPS-të duhet t'i kontrollojë dikush në çdo institucion. MAP-ja kontrollon vetëm MAP-në, të gjitha institucionet kontrollojnë institucionet e veta. Ministria e Administratës Publike ka vlerë për të gjitha institucionet, dhe nëse institucionet nuk kanë bërë analiza, nuk kanë kontrolluar ku janë ato automjete, sa kanë qenë të lëvizshme. Kjo çështje është pak më e vështirë, sepse për mendimin tim, ekzistojnë teknologji të reja, të cilat janë shumë më të avancuara këto vitet e fundit. Sidoqoftë, ne do ta dërgojmë raportin, të gjitha shpenzimet të cilat janë realizuar dhe raportin sa kanë ndikuar në kursim. Unë besoj që ka pasur ndikim, por gjithsesi ne duhet të shikojmë për mundësi të reja. Sa i përket përdorimit apo keqpërdorimit të automjeteve, çdo institucion është përgjegjës për pajisje të veta. Ekziston rregullorja për përdorim të automjeteve, e cila është aprovuar nga Zyra e Kryeministrit dhe çdo institucion duhet ta respektojë. Në këtë rast, ne si MAP, për menaxhimin e Ministrisë së Administratës Publike, mund të themi që është mirë, por ende ekzistojnë mundësi të bëhen përmirësime. Sa i përket pajisjeve dhe pjesëve, prapë është një proces tenderimi, sepse bëhet në fillim viti tenderimi dhe bëhet me kontrata dy apo tre vjeçare, pas tri viteve analizimi i tregut nuk është i lehtë, prandaj unë jam i mendimit që duhet të bëhet analizimi dhe duhet të bëhet në nivelin e të gjitha institucioneve, sidomos të bëhet sipas llojeve të automjeteve dhe atëherë do të ketë kursim. Deri tani, është realizuar sipas llojeve të tenderëve, nëse ka prapë lëshime, ne do të mundohemi sipas rekomandimeve t'i rregullojmë këto çështje.

Zëvendëskryetari – Z. ministër, ndoshta ne po e zgjerojmë pak diskutimin, por kemi arsye, sepse ju jeni MAP, ju duhet ta mbuloni edhe infrastrukturën juridike të këtij lëmi dhe këto sugjerime që po na i jepni neve, duhet t'i jepni në Qeveri. Cilët janë hapat që ju i keni ndërmarrë? Pra, idenë që e dhatë për një qendër të servisimit është e mirë, por duhet ndërmarrë edhe në fusha tjera, edhe në furnizim të pjesëve dhe në të gjitha pjesët tjera të mirëmbajtjes. Pra, jeni një ministri që në mënyrë indirekte involvoheni në këtë proces dhe në ministri tjera. Realisht nga ju duhet të ketë një udhëzim administrativ në mënyrën e përdorimit të automjeteve, në mënyrën e kontrollimit të shpenzimeve. Po ju përmendi disa raste konkrete, çmimi më i ulët për filtër të naftës, që në ofertë është prezantuar me 10.51 euro, në Policinë e Kosovës është blerë për 29.25 euro, në dogana është blerë për 47 euro, këtë është dashur që ju ta kontrolloni dhe ta reflektoni në Qeveri. Ndërsa çmimi më i ulët për filtër të vajit është 64.62 euro, ndërsa në doganë është paguar për 150 euro. Ju lutem, këto janë para publike.

Mahir Yagcilar – Si ministër i Ministrisë së Administratës Publike, kemi shumë përgjegjësi tjera. Në këtë rast, çdo institucion është përgjegjës për shpalljen e tenderit, nëse bëhet tenderimi qendror, atëherë bëhet përmes Agjencisë së Prokurimit. Në këtë rast, unë prapë mund të them për MAP-në, se ne kemi iniciuar dhe realizuar disa projekte, por a kanë qenë të suksesshme apo jo, prapë ajo vlerësohet, por drejtpërdrejt është rregullorja nga Zyra e Kryeministrit. Ne jemi të gatshëm që pas përfundimit të gjitha këtyre kontratave, të kalojmë në prokurimin qendror që të realizohen edhe rekomandimet e auditorit të përgjithshëm. Në këtë aspekt, ne jemi munduar të bëjmë sa më mirë. Ka rezultate, por nuk janë të mjaftueshme.

Adem Grabovci – Ministër, unë dua të ndalem te një projekt konkret. Ju thatë që në vitin 2007 ka filluar, a keni të dhëna se sa është realizuar ky projekt në praktikë?

Mahir Yagcilar – Në këtë moment jo, por ne do t'ia dërgojmë këto të dhëna Komisionit.

Adem Grabovci – Jo, është një anë negative që duhet ditur dhe kjo është shumë me rëndësi. Nuk mund të pajtohem se ka avancuar teknologjia, të lutem nuk mundemi që ne tash të gjykojmë si në rrethanat e vitit 2007, ku ka qenë Kosova dhe institucionet tona, me ato të vitit 2015, sepse kemi avancuar shumë. Unë jam plotësisht dakord se duhet edhe ne të avancohemi edhe në këtë fushë. Por, sa është zbatuar, deri ku ka arritur ky projekt dhe cilat janë rezultatet që ka dhënë ky veprim? Prandaj, ne duhet të mendojmë së bashku me auditorët, për rekomandimet që vijnë dhe duhet gjetur një formë, a është me interes të kemi një zyrë të veçantë për krejt prokurimin apo çka? Pra, të gjejmë një sistem për të mos lejuar këtë, se këtu po shihet se kemi të bëjmë me keqpërdorim. Si ministri, si institucion, a e keni ngritur këtë shqetësim në Qeveri?

Bali Muharremaj – Në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike është themeluar njësi për monitorimin dhe përdorimin e automjeteve qeveritare. Udhëzimi administrativ 03/2008 obligon të gjitha institucionet qeveritare të raportojnë në bazë mujore për numrin, përdorimin dhe menaxhimin e automjeteve qeveritare, njësi sipas udhëzimit administrativ, është e obliguar të përgatisë raporte mujore përmbledhëse dhe MAP t'ia dorëzojë Zyrës së Kryeministrit, deri më datën 10 të muajit pasues. A i keni dorëzuar këto raporte më herët?

Hajdar Beqa – Do të ndalem te menaxhimi i personelit. Ne e dimë se sipas nenit 30, pika 4 e Ligjit të shërbimit civil, duhet të respektohet afati për ushtrues detyre. Afati ligjor për mbajtjen e pozitës, ushtrues detyre, ishte tejkaluar në dy raste, në bazë të këtij auditivi. Pse ministria nuk e ka respektuar këtë afat ligjor? Pastaj keni një rast ku ishte bërë avancimi në pozitë, pa procedura të avancimit, siç e përcakton neni 27 i Ligjit për shërbyes civilë dhe Rregullorja 22/12 për avancimin në karrierë të punësuarve civilë. Pse nuk është respektuar rregullorja për avancim, në të gjitha këto mbajtja e pozitave të udhëheqësve dhe mosrespektimi i procedurave për avancim mund të rrezikojë arritjen e objektivave të ministrisë. Po ashtu pagesat nga Fondi i Kuadrove, pa vendim përkatës dhe moszbatimi i aktit të emërimit, rrisin rrezikun për kryerjen e pagesave pa bazë ligjore. Pse menaxhmenti nuk ka përgatitur një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditorit, në këtë rast auditorit të brendshëm?

Synavere Rysha – Në bazë të raportit, shihet se rekomandimet e auditorit të brendshëm janë zbatuar për 50%, një pjesë tjetër është në fazën e implementimit dhe dy nuk janë adresuar ende. Kur do të bëhet një implementim i rekomandimeve në një nivel më të lartë për 90% apo 100% nga ana e ministrisë?

Mahir Yagcilar – Ne jemi duke u marrë me çështjen e ndërtimit dhe po presim pëlqimin nga komuna. Shumë çështje vonohen, kështu që do të fillojmë me kuartilin e dytë të ndërtimeve. Gjithashtu, shpenzimet teknologjike kanë pasur një rritje për pagesa të licencave për tri vitet e ardhshme. Sa i përket çështjes së ushtrueseve të detyrës, kanë qenë dy raste, njëra ka qenë për dorëheqjen e drejtorit të Institutit të Administratës Publike. Ne kemi bërë shpalljen e konkursit, por kemi pritur formimin e Qeverisë, ndërsa për drejtorin për Reformën në administratë publike, disa herë kemi shpallur konkurse të brendshme dhe kanë dështuar konkurset, ose nuk i kemi gjetur personat që i plotësojnë kushtet. Një rast ka qenë edhe nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës Civil dhe tash jemi në fazën e fundit dhe besojmë që së shpejti do të bëhet zgjidhje për këto pozita. Adresimi i rekomandimeve të brendshme do të bëhet edhe në një nivel më të lartë. Sa i përket Fondit të Kuadrove, është bërë me një vendim që nuk është përsëritur dhe besoj që në të ardhmen

do të merren vendime veç e veç. Subvencionet ndahen në bazë të vlerësimit të Komisionit dhe nënshkrimit të ministrit dhe do të bëhen raporte edhe brenda ministrisë dhe jo vetëm nga përfituesit.

Zëvendëskryetari- Në mungesë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni dhe në bazë të rregullave të Komisionit, në pajtim me anëtarët e tij, raporti i performancës për këtë institucion shtyhet për takimin e radhës së Komisionit.

Zëvendëskryetari- Sa i përket Doganave të Kosovës do të trajtohet raporti i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 dhe Raporti i Performancës për Mirëmbajtjen dhe Servisimin e Automjeteve. Fjalën e ka auditorja që e ka bërë këtë auditim.

Vlora Mehmeti - Opinioni i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare për Doganat e Kosovës është Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes. Kjo do të thotë se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, megjithatë te theksimi i çështjes ne kemi ngritur faktin se evidencat e mbajtura dhe informatat e prezantuara te shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në PVF nuk ishin të plota. Vlerësimi ynë është se evidencat e mangëta dhe trajtimi i të hyrave të pa arkëtuara mbeten sfidë për Doganën.

Ne duhet të cekim që Dogana ka arritur progres në implementimin e rekomandimeve. Buxheti për 2014 është shpenzuar 92%, po ashtu kontrollet ishin funksionale në të gjitha fushat. Plani i të hyrave nuk është përmbushur plotësisht, përmbushja e planit ishte vetëm 93%. Në një rast gjatë llogaritjes të vlerës së mallrave për qëllime doganore, dogana ka kaluar nga metoda 1 në metodën 6 dhe nuk ka dhënë shpjegime pse ka kaluar nga një metodë në tjetrën.

Mungojnë informata për gjendjen fillestare të stokut në Depotë Doganore. Tjetra është kthimi i mjeteve, si rezultat i procedurave ankimore. Sistemi i kontrollit të brendshëm në menaxhimin e shpenzimeve është i dizajnuar mirë dhe funksionon në përputhje me atë, me përjashtim të disa dobësive në Prokurim dhe te Pagat dhe Mëditjet.

Gjatë vitit 2014, kishte lëvizje të zyrtarit të pasurisë, si rezultat, blerjet e pasurisë prej shtatorit 2014 deri në përfundim të vitit në vlerë prej 125,785€ nuk janë përfshirë në regjistrin kontabël dhe regjistrin e përgjithshëm të pasurive.

Zëvendëskryetari- Është mirë të na tregoni se cilat janë arsyet për mos adresimin e këtyre dy rekomandimeve që janë cekur në raport dhe një çështje tjetër është numri i madh i ankesave për vlerësimin e mallrave në doganë. Çfarë keni ndërmarrë dhe çfarë do të ndërmerri në adresimin e këtij problemi?

Hajdar Beqa- Fokusi im do të jetë te të hyrat e pa arkëtuara, si prioritet i lartë, trajtimi i borxheve mbetet ende sfidë për doganën, mungesa e një analize për të identifikuar arsyet e dështimit të bizneseve të caktuara nga dogana çka ka rezultuar me një inkasim të dobët të të hyrave dhe duhet të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për të identifikuar këto dështime. Drejtori i Përgjithshëm duhet të identifikojë të gjithë borxhlinjtë e doganës dhe të vlerësojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxhit.

Synavere Rysha- Duke e ditur që dogana është një nga aktorët kryesor për mbushjen e buxhetit të Kosovës, atëherë një nga elementet kryesor këtu është mos inkasimi i të hyrave. Pse nuk po arrini ta bëni arkëtimin e të hyrave dhe çka keni ndërmarrë që ta bëni inkasimin e këtyre të hyrave?

Lulzim Rafuna- Ne për herë të parë vitin e fundit kemi bërë prerjen e Depove Doganore dhe kemi vendosur një sistem elektronik ku çdo gjë në kohë reale tani monitorohet. Mirëpo ky sistem është futur në muajin mars dhe auditori nuk ka arritur me audituar, sepse auditimi është kryer në muajin janar. Tani kjo mangësi është eliminuar dhe gjithçka do të kemi tani në kohë reale. Sa i përket kthimit të mjeteve, ne kemi vendosur sistemin për kthimin e mjeteve me kupon fiskal. Ne kemi bërë kthimin e mjeteve, e jo si rezultat i numrit të ankesave. Sistemi me kthim ka rezultuar në rritjen e shumës prej 1.5 milion eurove, në fakt kthimet ndaj ankesave të aprovuara janë vetëm 500 mijë euro. Mirëpo sa i përket numrit të ankesave që bëhet në Doganën e Kosovës gjatë një viti në bazë të vlerësimeve të doganës sillet vetëm 1%, kurse 99% e importeve, numrave doganorë që pranohet janë pa ankesa. Sa i përket pasurisë që nuk është regjistruar arsyeja është zhvendosja e doganës në një objekt tjetër dhe si rezultat pasuria ka mbetur e pa regjistruar për këta dy muaj. Por me kalimin në një objekt tjetër, ne kemi themeluar komisionin dhe kemi bërë regjistrimin e pasurisë.

Kurse sa i përket borxheve, në vitin 2014 kemi themeluar njësinë e borxheve vetëm për identifikim të borxheve, ku kemi marrë masa vitin e kaluar duke ndaluar importin për të gjithë borxhlinjtë. Mirëpo po kemi probleme me personat fizikë, të cilët vozitin vetura të padoganuara dhe ne, si doganë, nuk po kemi mundësi për t'i kapur, sepse nuk po kalon nëpër procedura doganore. Në 92% të rasteve nuk vlerësojmë mallra në doganë, janë vetëm 8% e rasteve kur vlerësojmë mallra, në këtë përqindje përfshihen mallrat që vijnë nga Kina, Turqia dhe e treta është çështja e veturave të cilat vijnë pa kurrfarë dokumenti dhe i vlerësojmë sikurse edhe të gjitha doganat në vendet e tjera, në bazë të katalogut për vlerësim.

Zëvendëskryetari- Zoti drejtor, ne poashtu kemi edhe Raportin e Performancës për Mirëmbajtjen dhe Servisimin e Automjeteve. Dogana i ka 110 automjete dhe nga viti në vit i keni rritur, keni pasur 83, pastaj i keni pasur 81 dhe tani i keni 110, por të jemi më konkret, fjalën ia jap auditorës që e ka kryer këtë auditim.

Fatlinda Ramosaj- Desha me e cekur, se dogana veç ka filluar me implementimin e rekomandimeve, deri tani është e vetmja që e ka dorëzuar planin e veprimit. Por edhe te dogana e kemi vërejtur mos vlerësimin e nevojave me sasi të parashikuara, evidentimi vetëm për shumën e shpenzuar dhe jo për llojin dhe sasinë e pjesëve të ndërruara. Ky është një prej rekomandimeve që veç ka filluar me u implementuar, sasia e nevojshme nuk është specifiku te asnjë institucion, as te dogana, përveç te një rast. Mirëpo gjatë vlerësimit të ofertave nuk është marrë parasysh sikur të mos ishte paraparë ajo sasi, procedurën e hapur e ka përdorë, mirëpo konkurrenca nuk ka qenë në nivel të mjaftueshëm. Ne kemi vlerësuar se edhe një nga kriteret e panevojshëm ka qenë autorizimi nga prodhuesi, meqë automjetet nuk janë as të vjetra, edhe ky është një rekomandim që veç ka filluar me u implementuar, sa i përket çmimeve, ne vlerësojmë se nuk ka qenë e arritur vlera në para, çmimet janë shumë të larta dhe ka pasur një kursim të mundshëm.

Zëvendëskryetari- Çmimi më i ulët për filterin e vajit sipas ofertave që ju keni marrë ka qenë 64.62 euro, ndërsa ju e keni paguar atë 150 euro, çmimi më i ulët për filterin e benzinës është 7.5

euro, ndërsa ju e keni paguar 46.5 euro. Unë e kuptoj që kjo është përgjegjësi dhe krejt kjo na flet se kostoja është shumë e shtrenjtë.

Hajdar Beqa- U tha paraprakisht se artikujt e njëjtë të blerë nga organizatat buxhetore të ndryshme në periudhë të njëjta, duhet të kenë përafërsisht çmim të njëjtë, edhe pse ne jemi të vetëdijshëm që tregu i cakton rregullat dhe ky ligj i prokurimit për secilën procedurë, edhe për të njëjtën organizatë edhe për organizatë tjetër mund ta ndërrojnë çmimin, por për artikujt të njëjtë kemi dallim minimal, një çmim minimal për një artikull është 3%, ndërsa çmimi maksimal është 628%, pra është një dallim shumë i madh, pyetja është pse nuk keni kërkuar asnjëherë bashkëpunim me organizata buxhetore tjera për të parë se mos ndonjëra prej tyre janë duke u furnizuar ndoshta edhe nga i njëjti operator ekonomik prej të cilës furnizohet edhe organizata e juaj me çmim më të ulët se sa që Ju e keni kontraktuar.

Synavere Rysha- Në raport thuhet se Dogana e Kosovës ka rezultuar të jetë joekonomike apo mos ta rriti vlerën për para të shpenzuar për mirëmbajtjen referent të automjeteve. Pra raporti i performancës është shumë i keq për juve si doganë, kjo dokumentohet me shifra, sa keni shpenzuar dhe sa është dashtë realisht me qenë sipas çmimit të tregut, raporti i auditimit për ju tregon se shpenzimet kanë qenë 90.995 euro, dhe sipas çmimit të tregut ju është dashtë të shpenzoni 65.748 euro, ju keni dështuar për shumën 25.247 euro, pse ka ndodh kjo zoti drejtor?

Lulzim Rafuna- Prej që unë e kam marrë pozitën e drejtorit, kjo është kontrata ime e parë që e kam shkëputur, në momentin e parë unë vetë jam përballë me faturën e parë prej 240 euro, përveç që e kam shkëput kontratën, unë kam angazhuar edhe njësitë hetimore që kanë kryer punën hetimore për të gjitha pjesët dhe kam ushtruar kallëzim penal në prokurori. Ne kemi shkëputur kontratën me këtë operator dhe kemi kontrata me operatorë të tjerë, ku çmimet janë shumë më të vogla. Gjatë këtyre dy viteve gjatë procesit të prokurimit, kam pasur rast që të shoh diçka që ka qenë shumë shqetësuese, e kjo është se operatorët kur ofertojnë luajnë me çmime, i identifikojnë veturat dhe ato pjesë që ndërrohen më shpesh, për shkak që amortizohen vijnë me çmime shumë të larta, pjesët të cilat nuk ndërrohen vijnë me çmime shumë të ulëta, kjo ka qenë shumë shqetësuese për ne dhe që po mundohemi që ta ulim konsumin dhe i kemi ulur shumë shpenzimet në momentin që e kemi shkëputur këtë kontratë, rekomandimet ne i kemi adresuar konform auditimit, e kemi përcjellë planin e veprimit edhe jemi duke e implementuar, rekomandimi final është shumë i mirë, që një autoritet i vetëm me u marr për krejt institucionet, edhe pse është një problem, se Kosova është shtet i vogël dhe në momentin kur një merret për servisimin e të gjitha institucioneve atëherë kjo krijon njëfarë monopoli, por mendimi im si udhëheqës i administratës dhe prej përvojës është se lizingu kishte me qenë zgjidhja më e mirë e mundshme.

Synavere Rysha- A keni bërë një analizë, apo po e përdorni vetëm si term lizingun, sepse ju si doganë ndoshta keni bërë një analizë të mirëfilltë. A keni hulumtuar, që brenda periudhës njëvjeçare, nëse shkoni me formën e lizingut, sa kishit me kursye apo kini me dalë edhe ma keq se me GPS -at?

Lulzim Rafuna- Unë e dhashë si ide, sepse në kohën e UNMIK-ut dogana ka shfrytëzuar lizingun për veturat dhe këtu ne kemi parë se sa janë benefitet, vetëm shkurtimi i kohës për pritje për servisim ka qenë shumë i vlefshëm për ne. Tani si Doganë e Kosovës kemi filluar me lizing për pajisjet e fotokopjes dhe kemi një ulje të shpenzimeve për 200% më pak.

Zëvendëskryetari- Sa i përket Administratës Tatimore të Kosovës, do të trajtohet raporti i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 dhe Raporti i Performancës për Mirëmbajtjen dhe Servisimin e Automjeteve. Fjalën e ka auditorja që e ka bërë këtë auditim.

Vlora Mehmeti – Opinioni i auditimit për pasqyrat financiare për ATK, është raport që tregon një pamje të vërtetë dhe të drejtë në të gjitha aspektet materiale. Pra është opinion i pamodifikuar, është me rëndësi të ceket që ATK -ja në përgjithësi ka vendosur kontrole të forta në fushën e të hyrave dhe ato po zbatohen në mënyrë efektive, megjithatë veprime shtesë kërkohen në implementimin e plotë të planit të përmbushjes së të hyrave, po ashtu kontroll më i shtuar rreth bizneseve joaktive, ne kemi identifikuar që ATK -ja ka një listë të bizneseve joaktive. Mirëpo disa nga bizneset nga ajo listë përfitojnë të hyra nga buxheti i Kosovës përmes kontratave të ndryshme. Sa i përket planit të veprimit të rekomandimeve, mund të themi që nuk është implementuar në tërësi.

Kontrollet në procesin buxhetor janë të mira, edhe pse buxheti është shpenzuar 96%. Po ashtu edhe çështja e buxhetit të pagave duhet të përmirësohet, për arsye se që nga viti 2009 buxheti për paga kompensohet nga buxheti i departamenteve të tjera të MF-ve. Kontrollet në fushën e shpenzimeve duhet të forcohen për të evituar anashkalimin e kërkesave ligjore.

Mangësi vërehen edhe në Menaxhimin e Pasurive të ATK-së, mos kryerja e vlerësimit të pasurisë, mos përdorimi i programit e-pasuria, zhvlerësimi jo adekuat i pasurisë. Vlera e obligimeve të papaguara është rritur për 40.022€ dhe rritja e llogarive të arkëtueshme nga viti në vit.

Zëvendëskryetari- Fillimisht do të ndalem të numri i rekomandimeve, te mos adresimi i tyre. Prej 13 rekomandimeve, vetëm 3 i keni adresuar, 4 i keni në proces, kurse 6 rekomandime nuk i keni adresuar. Cilat janë shkaqet e mos adresimit të këtyre rekomandimeve?

Synavere Rysha- Te pasqyrat financiare të ATK –së, është një konstatim evident që e ka gjetur auditori dhe që për mua është mjaft shqetësues, është për ato biznese që bëjnë kontrata ndërsa janë pasiv, d.m.th. ata nuk paguajnë tatim, por në anën tjetër bëjnë kontrata. Cilat janë ato biznese, pse i bëjnë, apo janë biznese të regjistruara sa për të marrë një kontratë, sepse kjo është një shkelje e cila nuk është dashtë të ndodhë në Administratën Tatimore të Kosovës?

Hajdar Beqa- Unë do të fokusohem te një çështje që është ndalur edhe auditori, që ka të bëjë me vonesat në rishqyrtimin e rimbursimit. Sipas ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës dhe procedurat e nenit 30, pika 4 të ATK –së, duhet të veprohet me kërkesën e aprovuar brenda 60 ditësh për rimbursim dhe a ka një kontroll të ATK –së, që kjo me të vërtetë të zbatohet sipas ligjit. Ne kemi informata në vonesën e zbatimit të kësaj pike dhe vonesat në zbatimin e kësaj pike, përveç që e obligon kthimin e rimbursimit gjithashtu e obligon ATK-në për kthim të interesit. A keni marrë masa sa i përket kësaj çështje?

Zëvendëskryetari- Është mirë të na sqaroni edhe punën e personelit, sepse auditori ka konstatuar se ka mospërputhje të koeficienteve dhe mungesa e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësi për çdo individ.

Nahit Sharku- Sa i përket rekomandimeve ATK –ja është munduar që brenda kapaciteteve t'i adresoj të gjitha rekomandimet, por në pjesën e të gjeturave të auditorit ne i kemi pranuar ato të gjetura që ekzistojnë. Ne kemi diskutuar për adresim të këtyre rekomandimeve, por dihet që disa rekomandime kërkojnë kohë sipas specifikave. Mosadresimi i këtyre rekomandimeve ka të bëjë me proceset që po ndodhin në ATK dhe ne do të vazhdojmë edhe në vitin 2015 me adresim të këtyre rekomandimeve. Sa i përket bizneseve që janë pasive, ATK-ja është e obliguar me ligj që bizneset që nuk funksionojnë t'i bartë së pari në pasivë, pastaj të bëjë çregjistrimin e tyre. Ne kemi pasur shumë takime me thesarin në mënyrë që ta zgjidhim këtë problem, sepse ky nuk është një problem vetëm që ka ndodhur në vitin 2014, por ka qenë problem që e ka përcjellë administratën, si shkak i ndryshimit të numrave të regjistrimit të bizneseve, sepse ne deri në vitin 2009 kemi pasur numra të regjistrimit që janë marrë nga zyra e regjistrimit të biznesit dhe pastaj ATK-ja me qëllim të menaxhimit më të mirë të bizneseve, ka lëshuar numra fiskalë në bashkëpunim me projektin e USAID-it në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë të bizneseve që menaxhohen dhe që janë aktive, si rezultat i kësaj, pastaj ka qenë një problem te pjesa e aplikacionit të thesarit, se bizneset duhet të kalojnë në numër fiskal, më pas të kemi lidhje online. Ne do të vazhdojmë përpjekjet që të kemi lidhje online me thesarin dhe deri me tani kemi dërguar vazhdimisht shënimet e bizneseve në mënyrë që thesari t'i ketë si informatë, por kjo ka mundësuar që një numër shumë i vogël i tyre të mos merret parasysh nga thesari gjatë transferimit të pagesave. Unë, si ushtrues detyre, në takimin e parë me ministrin kam kërkuar që së paku ato pagesa që i bën thesari të na informojë siç e informojmë edhe ne thesarin për bizneset pasive, në mënyrë që të eliminojmë edhe këtë numër të vogël të bizneseve. Tani unë kam marrë masa, i kam angazhuar të gjitha kapacitetet e ATK –së që t'i identifikoj se cilat janë këto biznese dhe së shpejti unë do kem raport detal në lidhje me numrin e rasteve, që ishin një numër shumë i kufizuar në raport me numrin e bizneseve që ATK -ja i menaxhon.

Sa i përket rimbursimeve, është shumë e saktë se ligji mbi ATK -në kërkon që çdo rimbursim të shqyrtohet brenda 60 ditëve, dhe si ATK gjatë dy viteve të fundit kemi ndërmarrë të gjitha hapat që zyrtarët tonë të jenë në përputhje me ligjin. Bazuar në të dhënat e ATK-së dhe konstatimin e FMN, gjatë viti 2014 mesatarja e kohës të shpenzuar për rimbursim ka qenë 45 ditë, por ne kemi pasur disa raste të cilat janë identifikuar, jo gjithmonë vetëm me fajin e administratës, por biznesi në raste të caktuara nuk ka qenë në gjendje të ofrojë informata për shkak që pronari i biznesit ishte jashtë vendit. Kjo nuk do të thotë se ne do të ndalemi te ky 45 ditësh, sepse standardet ndërkombëtare kërkojnë që rimbursimet të kthehen brenda afatit 30 ditor. Ne do të vazhdojmë të punojmë që t'i mbërrijmë standardet ndërkombëtare, kjo është objektivi që e kemi vendosur edhe brenda strategjisë 2015-2020 të ATK -së, po ashtu edhe sistemi i ri që do të fillojë të punojë që nga janari do të mundësojë edhe kthimin automatik të rimbursimeve bazuar në një menaxhim të riskut, që ne i kemi përgatitur diku rreth 19 kritere, që sistemi automatikisht do të bëjë një vlerësim të rimbursimeve dhe nëse kalohet ky modul i riskut dhe nuk kemi risk te këto biznese, atëherë në mënyrë automatike sistemi do të kthejë rimbursimet përmes procedurave ligjore. Sa i përket personelit, në bashkëpunim me USAID- in ne kemi përgatitur një model të performancës të vlerësimit të stafit dhe në vitin 2014 kemi zbatuar këtë model të vlerësimit të inspektorëve në fund të vitit dhe i kemi përzgjedhur diku rreth 49 inspektorë që kanë performuar më mirë në bazë të vlerësimit të eprorëve, por kjo nuk ka ecur në procedurat e administratës publike dhe tani kemi ngelur, në një anë kemi kontratën të nënshkruar me personelin, në anën tjetër nuk është ekzekutuar në administratën publike. Ne kemi bërë përpjekje përmes zyrtarëve përgjegjës, por besoj që ka vend këtu të diskutohet brenda administratës. Sa i përket përkrahimit të punëve, ne si ATK, kemi përgatitur rregulloren në përputhje me kërkesat ligjore, i kemi dërguar në ministri dhe në qeveri dhe çdo pozitë ka përkrahim të punës, por ne kemi aplikuar një

model për menaxhimin edhe të kohës, edhe të vijueshmërisë. Ne kemi kërkuar nga personeli që edhe dosjet fizike të pasqyrohen me të gjitha përshkrimet, dhe në kohën kur auditori ka qenë në ATK. Ne kemi qenë në fazën e ndryshimit dhe plotësimit të dosjeve dhe kjo mund të jetë edhe shkak pse në disa raste ka munguar përshkrimi, pasi që kemi punuar në ndryshimin e përshkrimit të punës.

Sa i përket çështjes së shpenzimeve jemi munduar brenda mundësive të ATK –së, që ato të reduktohen në mënyrë maksimale, janë vërejtur disa lëshime nga auditori, të cilat sektori i prokurimit i ka dhënë argumentet, por mbi të gjitha unë, si ushtrues detyre, kam kërkuar që deri në fund të këtij viti nuk do t'i kemi këto gabime.

Fatlinda Ramosaj - Për dallim nga shumica e administratave buxhetore të audituara, ATK –ja mbanë regjistër për pjesët e ndryshuara dhe të riparuar, qoftë nga lloji dhe sasia, mirëpo e keqja e kësaj qëndron se gjatë vlerësimit të nevojave reale nuk janë përdorur ata regjistra. Edhe çmimet ATK -ja i ka më të përafërta me tregun dhe në shumicën e rasteve i ka më të ulëta se të gjitha organizatat tjera buxhetore. Mirëpo prapë me një vlerësim më të detajuar të nevojave, siç e kemi cekur ATK-ja kishte mundur me kursye, sikur kontratat të ishin ndarë në pjesë dhe të ishte paraparë sasia që do të furnizoheshin, do të kishte kursime të dukshme edhe në ATK.

Zëvendëskryetari- Në raport ju e keni cekur se, çmimi më i ulët për një anllaser e keni 60 euro, në ATK është paguar 250 euro, pastaj te boshpompa, çmimi minimal është 60 euro, ndërsa në ATK është paguar 101.97 euro, kështu që ka vend për përmirësim. Ju, po ashtu, në ATK e keni rritur numrin e automjeteve, e keni pasur 95, pastaj e keni pasur 108, momentalisht e keni 124.

Nahit Sharku- Është e vërtetë se ATK -ja është munduar që viteve të fundit të bëjë një menaxhim më të mirë të pasurisë dhe të pjesëve të automjeteve, për këtë arsye ne kemi krijuar një aplikacion që në baza ditore t'i marrim të dhënat, qoftë për shpenzime në kilometër, qoftë në shpenzime për secilin automjet dhe besoj që përdorimi i kësaj pjese të aplikacionit i ka dhënë rezultatet e saj në mënyrë që të kemi një menaxhim më të mirë, por përkundër kësaj ne po shohim se ka ende punë për të bërë, përveç kësaj ky aplikacion mundet me u përdorë edhe për menaxhimin e pjesës së çmimeve, sepse nëse futen të gjitha çmimet në këtë aplikacion atëherë në momentin që i krijojmë procedurat e prokurimit, mund të shfrytëzojmë si informata dhe të eliminojmë mënyrën e diferencave, por shihen disa elemente që ka vend për përmirësim.

Fatlinda Ramosaj – Unë do të doja të shtoja edhe diçka, për kërkesat e ulëta, sepe automjetet janë shumë të vjetra. Ne kemi vlerësuar që duhet të bëhet eliminimi i konkurrencës me kritere të larta të panevojshme.

Hajdar Beqa- Në rastin kur ATK-ja kishte përdorur si kriter për dhënie të kontratës tenderin ekonomik, ATK-ja kishte vendosur çmimin në kombinim me tri kritere, numrin e punëtorëve, autorizimin nga punëdhënësi dhe pikat e servisimit. Konsideroj se në bazë të ligjit të prokurimit këto duhet ta bëjnë ofertën e përgjegjshme, mirëpo jo të jenë pika për me fituar, në këtë rast nëse ka qenë 50% çmimi dhe 50% kanë qenë kriteret, asnjëra prej tyre nuk janë kritere në këtë rast. Përse kërkesat e tepërta, për shembull, autorizimi nga prodhuesi, kur shumica e automjeteve në administratë janë të vjetra dhe nëse e marrim edhe ligjin përkatës, në këtë rast nga Ministria e Financave, këto vetura janë jashtë tregut, kurse 20% është zhvlerësimi vjetor në bazë të ligjeve aktuale në Kosovë. Në këtë rast konsideroj se duhet të marrë një kontroll tjetër menaxhmenti apo ushtruesi i detyrës.

Nahit Sharku- Është e vërtetë se pjesa më e madhe e automjeteve janë të vjetra, edhe normalisht ato krijojnë mundësi që të ketë edhe kosto. Kriteret që kemi vendosur viteve të fundit që të jetë shtrirja në tërë territorin e Kosovës, lidhet me specifikat e ATK –së, sepse kemi 10 rajone dhe shpesh herë automjeti për një servisim është dashur të vijë në Prishtinë dhe të humbin 3-4 ditë, dhe kjo ka qenë arsyeja që ne kemi kërkuar, që të kemi shtrirje më të gjerë, së paku në disa rajone në mënyrë që të jemi më efikas dhe të shkurtojmë kohën e qëndrimit të automjeteve. Unë kam kërkuar edhe prej stafit përgjegjës se kemi nevojë për automjete të reja, sepse me të vërtetë jemi shumë keq me këto automjete të vjetra.

Hajdar Beqa- Ne po flasim për kritere, pikërisht këto kritere janë kritere bazike që e bëjnë një operator të përgjegjshëm dhe apo të papërgjegjshëm, por asnjëra prej tri kritereve, as autorizimi, as numri i punëtorëve, por as servisimi në këtë rast nuk janë kritere vlerësuese.

Nahit Sharku- Të jem i sigurtë, këto kritere më tepër janë kërkesa të menaxhmentit se sa të vetë zyrës së prokurimit dhe nuk kam dëshirë që për këtë pjesë t'i lë fajin zyrës së prokurimit, sepse ka qenë kërkesë më shumë menaxheriale, ndoshta kemi gabuar, por megjithatë do të ulemi me sektorin e prokurimit dhe t'i harmonizojmë kërkesat menaxheriale me ato ligjore.

Zëvendskryetari- Në mungesë të kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Enver Peci dhe në bazë të rregullave të Komisionit, në pajtim me anëtarët e tij, raporti i performancës për këtë institucion shtyhet për takimin e radhës së Komisionit.

Përfundim

Pasi të bëhet shqyrtimi edhe me Policinë e Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, atëherë do të merret vendimi i dërgimit të këtyre raporteve për shqyrtim në seancë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.
Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu